



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2062/1 prot.

Tiranë më 26.09.2024

Lënda: Dhënie mendimi për një projektvendim

**MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.11369/1 prot., datë 17.09.2024 administruar me tonën me nr. 2062 prot., datë 19.09.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e formimit profesional publik”, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Fillimisht, vërejmë se qëllimi i këtij projektvendimi është vënia në funksion e një baze të dhënash shtetërore elektronike për administrimin e Sistemit të Formimit Profesional (SFP). Ky sistem do të përmbajë ndër të tjera të dhëna duke filluar nga procesi i regjistrimit të kursantit në kursin e formimit profesional deri në certifikimin e tij si dhe do të menaxhojë dhe organizojë proceset e punës në fushën e formimit profesional, duke siguruar informacion të përditësuar në kohë reale për përdoruesit e tij.

Për sa më lart, meqenëse proceset përpunuese të të dhënave personale të parashikuara në këtë projektvendim janë të një game të gjerë dhe përfshijnë disa institucione që do të jenë pjesë e këtij procesi, respektimi i parimeve dhe standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale përbën një detyrim thelbësor.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes në tërësi i projektvendimit, në të parashikohen disa standarde për mbrojtjen e të dhënave personale, megjithatë, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj edhe të sugjerimeve në vijim.

Lidhur me pikat konkrete vërejmë se, ***në germën b), të pikës 3 të projektvendimit***, si pjesë e “*të dhënave dytësore*” konsiderohen të dhënat që merren nga ndërveprimi me sistemet informatike të institucioneve të tjera, ku parashikohet aksesimi edhe me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

Mënyra e përpunimit të të dhënave personale të gjendjes civile, aksesimi në këto të dhëna, si dhe mënyra e ndërveprimit të databazave të tjera me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile gëzojnë një rregullim të posaçëm ligjor, konkretisht bazuar në pikat 2, 2/1 dhe 3, të nenit 3, të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.

Në këtë kontekst, detyrimet që burojnë nga dispozitat e mësipërme ligjore, janë zbërthyer me Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” i ndryshuar, i Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për këtë arsye, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (në vijim “AKPA”), në cilësinë e kontrolluesit, në zbatim të pikës 12, të Udhëzimit të përbashkët nr. 463 të sipërcituar, duhet të ndërmarrë masa për paraqitjen e kërkesës për përfshirjen e institucionit në Aneksin 1 (*Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni*), të këtij Udhëzimi.

Ritheksojmë që ky është një detyrim që buron nga ligji i posaçëm nr. 10129/2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar, dhe legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat parashikojnë dispozita konkrete dhe specifike, në kuadër të këtij procesi përpunimi të të dhënave personale dhe ndërveprimi i databazave me shërbimin e gjendjes civile, të cilat duhen respektuar nga çdo kontrollues.

Lidhur ***me pikën 5, të projektvendimit*** parashikohet se: “*Të dhënat personale të grumbulluara ruhen jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.*”

Caktimi i një afati kohor mbi ruajtjen e të dhënave përbën një nga kriteret bazë në zbatim të germës d), të nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, sipas së cilit parashikohet që mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. Në rastin konkret, gjendet e nevojshme të përcaktohet ***një afat kohor konkret*** për ruajtjen e këtyre të dhënave si dhe ***mënyra se si do të bëhet fshirja e tyre.***

Referuar ***pikës 6, të projektvendimit***, në fjalinë e dytë të paragrafit sugjerojmë që togfjalëshi “...e drejta për të hedhur të dhëna” të zëvendësohet me togfjalëshin “...ai fillestar, i përcaktuar në momentin e mbledhjes së të dhënave”.

Me përfshirjen e sa më sipër, projektvendimi vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**